

**QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE**

# **Matura Shtetërore 2020**

## **MODEL TESTI**

**Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi**

**Tiranë 2020**

## PJESA I – Gjuhë shqipe

**Lexoni tekstin e mëposhtëm dhe përgjigjuni pyetjeve në vijim.**

### *Ajri*

Ulu për një moment në karrigen tënde dhe për t'u qetësuar merr frymë thellë. Mbase kjo nuk është e mundur.

Studimet kanë treguar se ajri brenda shtëpisë shpeshherë është 10 deri në 100 herë më i ndotur se ajri jashtë saj. Një nga kontribuesit më të mëdhenj në ndotjen e ajrit është gazi që lëshohet në ajër. Shumica e materialeve në shtëpitë tona përbëhen nga kimikate të quajtura “sintetike”. Ato janë prodhuar nga vetë njeriu dhe jo nga natyra. Këto kimikate janë të shumëllojshme dhe përdoren në plastika, kompjutera, televizorë, tapete etj. Ekspozimi ndaj një kimikati të vetëm mund të shkaktojë probleme të rënda për shëndetin. Kur kombinohen disa kimikate për të formuar një trup të ngurtë, përgjithësisht produkti final është i sigurt. Por jo të gjitha kimikatet bashkëveprojnë kështu. Këto produkte lëshojnë gazra ose çdo lloj kimikati tjetër. Disa nga këto kimikate shfaqin rrezikshmëri për shëndetin tonë.

Thuajse çdo material në shtëpi apo në shkollë mund të lëshojë gazra. Linoleumi, tapetet, pëlhurat, bojërat, ngjitësi çlirojnë në ajër kimikate. Po kështu edhe detergjentët, pastruesit e shtëpisë, plastika dhe letra. Për të pakësuar këtë, studiuesit rekomandojnë larjen e rrobave, krevateve dhe pëlhurave të ndryshme të paktën njëherë përpara se të përdoren. Pajisjet e reja dhe tapetet duhen lënë jashtë në ajër përpara se të vendosen.

Ndërsa një zgjidhje e fundit është edhe përdorimi i materialeve ndërtuese që nuk e dëmtojnë mjedisin, një zgjidhje më e shpejtë mund të jetë aq afër, sa edhe kopshti apo dyqani me lule që keni aty pranë. Shkencëtarët kanë zbuluar se bimët e zakonshme që rriten në shtëpi, mund të largojnë një sasi të madhe gazi nga ajri, veçanërisht kur brenda saj ka bimë me gjethë të gjera. Megjithatë, gjethet, rrënjët dhe bakteret e dheut luajnë rolin e tyre. Gjethet absorbojnë përbërës të ajrit dhe i kalojnë ato tek rrënjët. Rrënjët e shtyjnë ajrin tek dheu dhe tërheqin lart ujin. Mikrobet që jetojnë rreth rrënjës së bimës, i zbërthejnë përbërësit e gazit të emetuar në lëndë të parë të padëmshme dhe i përdorin ato si burim ushqimor, duke krijuar një pleh natyral, i cili bën që bima të rritet më e madhe dhe më e fortë.

Nëse dëshironi të rrisni disa bimë për të përmirësuar ajrin e shtëpisë suaj, cilën do të zgjidhni? Për një pastrim të mirë të ajrit rreth e qark shtëpisë, rrisni zambakë; nëse sapo e keni lyster shtëpinë apo keni përdorur plastikë të re në të, rrisni krizantema në vazo. Ato janë të shkëlqyera për të larguar benzenin nga ajri. Nëse jeni duke përdorur tretës boje, bojëra, ngjitës, hollues ose pesticide, rrisni një pemë hurme të shkurtër. Ajo largon ksilenin që lëshojnë këto materiale.

Por mbi të gjitha qëndron margarita. Sipas eksperimenteve të bëra nga NASA, kjo bimë është kampione në largimin e toksinave.

1. Kujt i drejtohet më së shumti kjo pjesë?

**1 pikë**

- A) Institucioneve shtetërore, të cilat dëshirojnë të rregullojnë problemet e ndotjes.
- B) Njerëzve, të cilët nuk kanë njohuri rreth problemeve të çlirimit të gazrave në shtëpinë e tyre.
- C) Ndërtuesve, të cilët janë të interesuar të përdorin materiale që nuk përmbajnë kimikate të dëmshme.
- D) Shkencëtarëve, të cilët studiojnë se si ekspozimi ndaj substancave sintetike, shkakton probleme me shëndetin.

2. Qëllimi i autorit në këtë tekst është: **1 pikë**
- A) të argumentojë, përmes shembujve konkretë, se ajri brenda shtëpive tona është më i ndotur sesa ai jashtë tyre.
  - B) të informojë dhe shpjegojë mbi disa nga mënyrat e shmangies së ndotjes së ajrit në shtëpitë tona.
  - C) të përshkruajë përpjekjet e njeriut për të shmangur ndotjen e ajrit në mjediset e brendshme të shtëpive tona.
  - D) të shpjegojë sesi ndikon ajri i ndotur në organizmin e njeriut.
3. Një nga zgjidhjet që rekomandojnë studiuesit për të pakësuar çlirimin e kimikateve në ajrin e shtëpive tona, është: **1 pikë**
- A) ajrosja e pajisjeve dhe rrobave përpara përdorimit.
  - B) mbajtja e dritareve hapur gjatë gjithë kohës.
  - C) ndryshimi i pajisjeve shtëpiake sa më shpesh.
  - D) përdorimi i detergjentëve të njohur për pastrim.
4. Ndryshimi midis lules së zambakut dhe krizantemës, margaritës apo pemës së hurmës është se ajo: **1 pikë**
- A) largon benzenin nga ajri.
  - B) largon toksinat nga kimikatet.
  - C) pastron ajrin nga ksileni.
  - D) pastron mirë ajrin e shtëpisë.
5. Cila është bima që duhet mbjellë për të penguar ndotjen e ajrit, nëse sapo kemi lyster shtëpinë? **1 pikë**
- A) Zambaku,
  - B) Pema e hurmës,
  - C) Krizantema,
  - D) Margarita.
6. Cili argument mbështetet me të dhëna në këtë pjesë? **1 pikë**
- A) Emetimi i gazrave në ajër përbën problem në shumicën e shtëpive sot.
  - B) Emetimi i gazrave në ajër mbetet një problem i pazgjidhur.
  - C) Përdorimi i materialeve natyrale është mënyra e vetme për të eliminuar çlirimin e gazrave.
  - D) Reduktimi i emetimit të gazrave në ajër garanton një shëndet të mirë.
7. Çfarë informacioni duhet të shtonte autori për të mbështetur idenë se cilësia e dobët e ajrit në shtëpi është problem serioz? **1 pikë**
- A) Një analizë të përparësive të materialeve sintetike.
  - B) Një krahasim të niveleve të ndotjes së ajrit brenda dhe jashtë shtëpisë nga kimikatet sintetike.
  - C) Një listë të problemeve shëndetësore që vijnë si pasojë e çlirimit të gazrave të dëmshme.
  - D) Një shpjegim të pasojave negative që gazrat e dëmshme shkaktojnë tek bimët.

- 8.** Përse shërben mënyra e organizimit të paragrafit hyrës në këtë tekst? **1 pikë**
- A) Për ta përfshirë lexuesin sa më natyrshëm në komunikim.
  - B) Për të ndihmuar përshkrimin e procesit të ndotjes së ajrit.
  - C) Për të rritur shkallën e objektivizimit të këtij teksti.
  - D) Për të paralajmëruar lexuesin se problemi i shtruar në tekst nuk ka zgjidhje.
- 9.** Struktura e tekstit të mësipërm është: **1 pikë**
- A) e krahasim – kontrastit,
  - B) e problem-zgjidhjes,
  - C) e renditjes së dukurive,
  - D) e kronologjisë.
- 10.** Ky tekst përmbush karakteristikat e llojit shpjegues, sepse: **1 pikë**
- A) përdor harta dhe grafikë shpjegues.
  - B) përdor përkufizime dhe citime të personaliteteve të spikatura të shkencës.
  - C) përfshin shpjegimin e termave shkencorë që ndihmojnë të kuptuarit e tekstit.
  - D) shmang përshtypjet e autorit gjatë shtjellimit të temës.
- 11.** Cilën teknikë përdor autori për të bindur lexuesit se çlirimi i gazrave është një çështje serioze? **1 pikë**
- A) Ai citon autoritete të njohura.
  - B) Ai përshkruan një përvojë personale.
  - C) Ai lë të kuptojë se të gjithë njerëzit e informuar pajtohen me idetë e tij.
  - D) Ai rrëfen studime me shembuj dramatikë të individëve të prekur nga ky problem.
- 12.** Kjo pjesë përmban karakteristika të gjuhës së tekstit udhëzues. Një prej tyre është: **1 pikë**
- A) përdorimi i fjalive pyetëse.
  - B) përdorimi i foljes në mënyrën dëftore.
  - C) përdorimi i foljeve modale të domosdoshmërisë.
  - D) përdorimi i gjuhës së figurshme.
- 13.** Cila nga fjalitë e mëposhtme përmban fjalë të leksikut të specializuar? **1 pikë**
- A) Gjethet absorbojnë përbërës të ajrit dhe i kalojnë ato tek rrënjët.
  - B) Ulu për një moment në karrigen tënde dhe për t'u qetësuar merr frymë thellë.
  - C) Nëse dëshironi të rrisni disa bimë për të përmirësuar ajrin e shtëpisë suaj, cilën do të zgjidhni?
  - D) Pajisjet e reja dhe tapetet duhen lënë jashtë në ajër përpara se të vendosen.
- 14.** Mjeti që siguron koherencën e paragrafit të fundit me atë pararendës, është një lidhëz që shënon marrëdhënie: **1 pikë**
- A) shtuese,
  - B) përmbyllëse,
  - C) kundërshtuese,
  - D) krahasuese.

**Teksti i dhënë më poshtë nuk është i saktë nga ana gjuhësore.**

**Lexojeni atë dhe qarkoni përgjigjen që ju mendoni si të saktë.**

### *Arinjtë polarë*

[1] Ndryshimet e klimës po e vështirësojnë mbijetesën e arinjve polarë. [2] Ndryshimet në klimë kanë shkaktuar një zgjatje të periudhës pa akull në gjirin Hudson. [3] Për pasojë është zgjatur koha gjatë së cilës arinjtë polarë duhet të qëndrojnë pa ushqim.

[4] Gjatë pranverës arktike, arinjtë vënë shtresa dhjami duke ngrënë foka, të cilat i gjuajnë nga akulli. [5] Temperaturat e ngrohta po i pakësojnë akujt. [6] Kjo sjell pasoja serioze për 2138 arinjtë që jetojnë në këtë rajon. [7] Akulli i deteve shkrin ç' do verë, duke detyruar shumë krijesa të zbarkojnë në breg, larg dietës me mish foke. [8] Meqenëse arinjtë polarë ushqehen edhe me lloje të ndryshme boronicash dhe manaferrash, ata humbasin nga një kilogram ç' do ditë përgjatë katër muajve. [9] Në rastin e femrave shtatzëna, kjo zgjat tetë muaj.

[10] Biologët kanë vite që përpiqen të përcaktojnë nëse arinjtë polarë që ushqehen me fruta pylli, e kanë më të thjeshtë të mbijetojnë gjatë muajve pa mish foke. [11] Ata u përpoqën të nxirrnin përfundime nga matjet në masën muskulore dhe në gjak, por pa sukses.

[12] Kohëve të fundit, kërkuesit u vendosën maska 300 arinjve polarë dhe mblodhën kampionë nga fryma e tyre. [13] Maskat ishin ndërtuar prej një materiali të përbërë me dru bambuje. [14] Përfundimet treguan se nuk ka ndryshime ndërmjet arinjve që kishin ngrënë fruta pylli (e dallueshme kjo nga mbetjet e frutave në dhëmbët e tyre) dhe atyre që nuk kishin ngrënë. [15] A mundet që një dietë me fruta pylli ta pakësojë nevojën e arinjve polarë për mish? [16] Përgjigjja është jo. [17] Ndryshe nga metabolizmi i arinjve të kafenjtë, metabolizmi i arinjve polarë nuk merr mjaftueshëm energji nga frutat e pyllit.

**15. Në cilën nga alternativat e mëposhtme, fjalitë [1] dhe [2] janë lidhur në një fjali të vetme, pa e ndryshuar kuptimin e tekstit?**

**1 pikë**

- A) Meqenëse ndryshimet e klimës kanë shkaktuar një zgjatje të periudhës pa akull në gjirin Hudson, ato po e vështirësojnë mbijetesën e arinjve polarë.
- B) Prandaj, ndryshimet e klimës po e vështirësojnë mbijetesën e arinjve polarë dhe kanë shkaktuar një zgjatje të periudhës pa akull në gjirin Hudson.
- C) Ndryshimet e klimës po e vështirësojnë mbijetesën e arinjve polarë dhe kanë shkaktuar një zgjatje të periudhës pa akull në gjirin Hudson.
- D) Ndryshimet e klimës po e vështirësojnë mbijetesën e arinjve polarë, për rrjedhim kanë shkaktuar një zgjatje të periudhës pa akull në gjirin Hudson.

**16. Cila është alternativa e saktë e shkrimit të numrit 2138?**

**1 pikë**

- A) Dymijë e një qind e tridhjetë e tetë,
- B) Dy mijë e njëqind e tridhjetë e tetë,
- C) Dy mijë e njëqind e tridhjetë e tetë,
- D) Dy mijë e një qind e tridhjetë e tetë.

17. Cila është alternativa që lidh fjalitë [5] dhe [6], pa ndryshuar rrjedhën logjike të tekstit? **1 pikë**

- A) Ngaqë temperaturat e ngrohta po i pakësojnë akujt, ato po sjellin pasoja serioze për 2138 arinjtë që jetojnë në këtë rajon.
- B) Temperaturat e ngrohta po i pakësojnë akujt, gjë që sjell pasoja serioze për 2138 arinjtë që jetojnë në këtë rajon.
- C) Temperaturat e ngrohta po i pakësojnë akujt, ndaj po sjellin pasoja serioze për 2138 arinjtë që jetojnë në këtë rajon.
- D) Temperaturat e ngrohta po i pakësojnë akujt, si dhe po sjellin pasoja serioze për 2138 arinjtë që jetojnë në këtë rajon.

18. Në fjalitë [7] dhe [8] gabimi qëndron në: **1 pikë**

- A) përdorimin e kohëve të foljes.
- B) përdorimin e shumësit të mbiemrit.
- C) shkrimin e emrit të rasës rrjedhore.
- D) shkrimin e përemrit të pacaktuar.

19. Në cilën nga fjalitë e tekstit, koha e tashme e dëftores është përdorur me kuptimin e së shkuarës? **1 pikë**

- A) Fjalia [1]
- B) Fjalia [6]
- C) Fjalia [9]
- D) Fjalia [10]

20. Në fjalinë [10] grupet emërore *fruta pylli* dhe *mish foke*, kanë të përbashkët faktin që: **1 pikë**

- A) janë grupe emërore në rasën dhanore,
- B) kanë fjalën përcaktuese në rasën kallëzore,
- C) kanë fjalën përcaktuese në rasën rrjedhore,
- D) nuk kanë asgjë të përbashkët.

21. Cila fjali në paragrafin e fundit përmban informacion të tepërt, që nuk është në të njëjtën linjë logjike me përmbajtjen e tij? **1 pikë**

- A) Fjalia [13].
- B) Fjalia [14].
- C) Fjalia [15].
- D) Fjalia [17].

22. Cili është roli i fjalisë së futur në kllapa në fjalinë [14]? **1 pikë**

- A) Është citim i drejtpërdrejtë i një specialisti të fushës.
- B) Jep të dhëna saktësuese.
- C) Tregon diçka të parëndësishme.
- D) Thekson një mendim të rëndësishëm.

**23.** Nëse fjalinë [15] dhe [16] do ta kthenim në një fjali pyetëse të zhdrejtë, në koherencë me përmbajtjen e pjesës, alternativa e duhur do të ishte: **1 pikë**

- A) Nëse pyesim, a mundet që një dietë me fruta pylli ta pakësojë nevojën e arinjve polarë për mish, përgjigjja është jo.
- B) Përgjigjja është jo për pyetjen: - A mundet që një dietë me fruta pylli ta pakësojë nevojën e arinjve polarë për mish?
- C) Pyetjes nëse mundet që një dietë me fruta pylli ta pakësonte nevojën e arinjve polarë për mish, iu përgjigjen jo.
- D) Studiuesit përgjigjen jo për pyetjen nëse a mundet që një dietë me fruta pylli ta pakësojë nevojën e arinjve polarë për mish.

**24.** Nëse fjalisë [17] do t'i shtonim të dhëna plotësuese në ligjërim e sipër, cili nga variantet e mëposhtme do të ishte më i saktë nga ana kuptimore dhe gramatikore? **1 pikë**

- A) Dihet që metabolizmi i arinjve polarë nuk merr mjaftueshëm energji nga frutat e pyllit, ndryshe nga metabolizmi i arinjve të kafenjtë.
- B) Ndryshe nga metabolizmi i arinjve të kafenjtë - dhe këtë e thonë shumë studiues - metabolizmi i arinjve polarë nuk merr mjaftueshëm energji nga frutat e pyllit.
- C) Siç doli më vonë, ndryshe nga metabolizmi i arinjve të kafenjtë, metabolizmi i arinjve polarë nuk merr mjaftueshëm energji nga frutat e pyllit.
- D) Siç duket, metabolizmi i arinjve të kafenjtë, ndryshe nga metabolizmi i arinjve polarë nuk merr mjaftueshëm energji nga frutat e pyllit.

---

**25.** Qarkoni alternativën që përmban *një përemër* të futur gabim sipas llojit. **1 pikë**

- A) shkëlqimin e vet,
- B) peshën e saj,
- C) të ftohtët e tyre,
- D) kangjella të tjera.

**26.** Cili është lloji i rrethanorit të veçuar në fjalinë e mëposhtme? **1 pikë**

*Duke kaluar nëpër pemë, më dukej sikur isha përpirë krejt nga një botë e tërë flore nëndetare.*

- A) Shkaku,
- B) Mënyre,
- C) Kohe,
- D) Vendi.

27. Cila është mënyra për ta zgjeruar kryefjalën e fjalisë së dhënë më poshtë me një *emër me parafjalë të rasës kallëzore*? **1 pikë**

*Tashmë historitë vijnë tek unë në të gjitha mënyrat e mundshme.*

- A) Historitë me aventura.
- B) Historitë nga e kaluara.
- C) Historitë e lashtësisë.
- D) Historitë e së shkuarës.

28. Qarkoni rastin kur fjala e *nënvizuar* është lidhëz. **1 pikë**

- A) Ka, madje, në mjaft raste edhe nyje brenda.
- B) Dhe ndiejnë dhimbje, në doni ta dini.
- C) Shkon për t'i vëzhguar në dimër.
- D) Më e vështirë është të depërtosh në tokë se sa në qiell.

29. Qarkoni fjalinë ku është përdorur trajta e shkurtër. **1 pikë**

- A) Unë u hoqa sikur s'kuptova gjë.
- B) Të ishte ashtu, degët atëherë do të ishin të drejta.
- C) Degët mbijnë, qielli u bën ballë dhe ato ndërrojnë drejtim.
- D) Fijet e litarit zgjidhen në të dy skajet për t'u kapur pas qiellit.

30. Cili është funksioni i shprehjes së nënvizuar në fjalinë e dhënë më poshtë? **1 pikë**

*Tundte sa mundte kovën që mbante në dorë e që kërciste me një farë zhurme që i bënte shoqëri.*

- A) Kundrinor i drejtë
- B) Kundrinor i zhdrejtë me parafjalë.
- C) Rrethanor mënyre.
- D) Përcaktor me bashkim.

## PJESA II – LETËRSI

### Poradeci

### Poradeci

Perëndim i vagëlluar mbi Liqerin pa kufir.  
Po përhapet dal-nga-dale një pluhurë si një hije.  
Nëpër Mal e nër Lëndina shkru mb' i natës që po bije,  
Dyke zbritur që nga qjelli përmbi fshat po bëhet fir...

E kudo krahin' e gjerë më s'po qit as pipëlim:  
Në Katund kërcet një portë...në Liqer hesht një lopatë...  
Një shqiponjë e arratisur fluturon në Mal-të- Thatë...  
Futet zemra djaloshare mun në fund të shpirtit t'im.

Tërë fisi, tërë jeta, ra...u dergj...e zuri gjumi...  
Zotëroj më katër anë errësira...

Po tashi:

Dyke nisur udhëtimin mes-për-mes nër Shqipëri,  
Drini plak e i përrallshëm po mburon prej Shëndaumi.

**31.** Cila është atmosfera që sugjerohet përmes **dy** vargjeve të para të kësaj poezie? **1 pikë**

- A) E paqtë dhe enigmatike.
- B) E zyrtë dhe melankolike.
- C) Entuziaste dhe e hareshme.
- D) E trazuar dhe e pikëlluar.

**32.** Në këtë poezi, *Liqeni* perceptohet si: **1 pikë**

- A) element natyror i përmasave të jashtëzakonshme.
- B) përgjithësim i liqeneve të atdheut të poetit.
- C) përqsasje simbolike me shpirtin poetik.
- D) alegori e ujërave që rrjedhin në kohë.

**33.** Ideja e lëvizjes dhe jetës që s'vdes kurrë, konkretizohet në imazhin që krijon: **1 pikë**

- A) lumi në udhëtimin e tij të pandërprerë.
- B) liqeni i përmasave pa kufi.
- C) madhështia e maleve dhe e lëndinave.
- D) zemra djaloshare, por e trazuar e poetit.

**34.** Cili është nënteksti i vargut: *Futet zemra djaloshare mun në fund të shpirtit tim?* **1 pikë**

- A) Momentet e rënies së natës e burgosin zemrën djaloshare të poetit.
- B) Në këtë etapë të jetës ka vdekur djaloshi në shpirtin e poetit.
- C) Shpirti i poetit është po aq i pafuqishëm sa edhe trupi, në këtë fazë të jetës së tij.
- D) Shpirti i poetit, ndryshe nga trupi, mbetet gjithmonë i ri.

- 35.** Cili nga çiftet e mëposhtme krijon antonimi të kontekstit poetik? **1 pikë**
- A) plak – i përrallshëm,
  - B) natë – errësirë,
  - C) ra – u dergj,
  - D) hesht – kërcet.
- 36.** *Perëndim i vagëlluar* ka kuptimin: **1 pikë**
- A) perëndim i ndritur,
  - B) perëndim i qetë,
  - C) perëndim i kuq,
  - D) perëndim i mjegullt.
- 37.** Cili nga vargjet e mëposhtëm ka një rend të përmbysur sintaksor? **1 pikë**
- A) Tërë fisi, tërë jeta, ra...u dergj...e zuri gjumi...
  - B) Drini plak e i përrallshëm po mburon prej Shëndaumi.
  - C) Një shqiponjë e arratisur fluturon në Mal-të- Thatë...
  - D) Nëpër Mal e nër Lëndina shkrumb' i natës që po bije
- 38.** Në vargun: *Nëpër Mal e nër Lëndina shkrumb' i natës që po bije*, metafora që i jep ngarkesë emocionale vargut, është e shprehur me: **1 pikë**
- A) emër,
  - B) mbiemër,
  - C) folje,
  - D) grup foljor.
- 39.** Lloji i rimës së përdorur në strofën e parë është: **1 pikë**
- A) e puthur,
  - B) e alternuar,
  - C) e përmbyllur,
  - D) varg i bardhë.
- 40.** Përdorimi i reticencës në vargjet e mëposhtme: **1 pikë**
- Tërë fisi, tërë jeta, ra...u dergj...e zuri gjumi...  
Zotëroj më katër anë errësira...*
- A) zgjon përfytyrime dëgjimore.
  - B) nxit përfytyrimin e një procesi në vazhdimësi.
  - C) është hapësirë e domosdoshme për veçimin e gjymtyrëve homogjene.
  - D) tregon se kemi të bëjmë me gjymtyrë plotësuese të fjalisë, të hequra qëllimshëm nga poeti.

41. Nisur nga kjo poezi, cili është një nga kuptimet e figurshme të fjalës së nënvizuar në vargun e mëposhtëm? **1 pikë**

Zotëroj më katër anë errësira...

- A) Ngjyrat e zeza të natës.
- B) Errësira e largimit nga jeta.
- C) Errësira e padituriisë.
- D) Malli për vendlindjen.

42. Me cilin nga vargjet hyjnë në kontrast dy vargjet e fundit? **1 pikë**

- A) Po përhapet dal-nga-dale një pluhurë si një hije.
- B) Një shqiponjë e arratisur fluturon në Mal-të- Thatë...
- C) Dyke zbritur që nga qjelli përmbi fshat po bëhet fir...
- D) Zotëroj më katër anë errësira...

43. Disa emërtime të përgjithshme vendore poeti i shkruan me shkronjë të madhe. Cila është një nga arsyet e këtij përdorimi? **1 pikë**

- A) Për të vijuar një traditë të hershme të shkrimit të tyre.
- B) Për t'i dhënë peshë kuptimore dhe stilistike fjalëve.
- C) Për të respektuar rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- D) Për të dëshmuar se këto mjedise natyrore janë të vetmet në Shqipëri.

44. Në vargun: *Dyke zbritur që nga qjelli përmbi fshat po bëhet fir...*, togu i nënvizuar ka kuptimin: **1 pikë**

- A) po tretet,
- B) po sundon,
- C) po dendësohet,
- D) po ngurtësohet.

45. Në cilin prej vargjeve është përdorur krahasimi? **1 pikë**

- A) Perëndim i vagëlluar mbi Liqerin pa kufir.
- B) Po përhapet dal-nga-dale një pluhurë si një hije.
- C) Një shqiponjë e arratisur fluturon në Mal-të- Thatë...
- D) Dyke zbritur që nga qjelli përmbi fshat po bëhet fir...

## Kamy

## *I huaji (fragment)*

Sot më vdiq mamaja. Apo ndoshta dje, nuk e di. Mora një telegram nga azili: "Nëna vdiq. Varrimi nesër. Ngushëllime të sinqerta". Kjo s' do të thotë asgjë. Ndoshta ka ndodhur dje.

Azili i pleqve ndodhet në Marengo, tetëdhjetë kilometra larg Algjerit. Do të marr autobusin e orës dy dhe do të jem aty pasdite. Kështu do të mund ta gdhij një natë e do të kthehem nesër mbrëma. I kërkova dy ditë leje pronarit dhe ai nuk mund të mos m'i jepte për një arsye të tillë. Por m'u duk se nuk i pëlqeu. Madje dhe i thashë: "S' është për fajin tim." Nuk u përgjigj. Atëherë mendova se nuk duhet ta kisha thënë atë fjalë. Sidoqoftë nuk kisha pse të kërkoja ndjesë. Ai bile duhet të më shprehte ngushëllimet. Do ta bëjë padyshim pasnesër, kur të më shohë në zi. Tani për tani duket sikur mamaja nuk ka vdekur. Ndërsa pas varrimit do të jetë çështje e mbyllur dhe çdo gjë do të ketë marrë formë zyrtare.

Në orën dy mora autobusin. Bënte shumë nxehtë. Hëngra në restorant, te Çelesta, si zakonisht. Të gjithëve u vinte shumë keq për mua dhe Çelesta më tha: "Vetëm një nënë kemi." Kur u largova, më shoqëruan deri te dera. Isha disi i hutuar, ngaqë m'u desh të ngjitesha tek Emanueli për t'i marrë hua një kravatë të zezë dhe një shirit të zi. Ai e ka humbur xhaxhanë para disa muajsh.

Vrapova të kap autobusin. Gjithë ai nxitim e ai vrap, me siguri për shkak të tyre, le pastaj edhe troshitjet, era e benzinës, afshi i nxehtë që vinte nga rruga e nga qielli, më vunë në gjumë. Fjeta thua jse gjatë gjithë rrugës. Kur u zgjova, pashë se isha ngjeshur pas një ushtaraku që më buzëqeshi dhe më pyeti nëse vija nga larg. I thashë "po" për të mos e zgjatur muhabetin.

Azili është dy kilometra larg fshatit. E bëra rrugën në këmbë. Desha të shihja mamanë menjëherë. Por portieri më tha se duhej të takoja drejtorin, prita ca meqenëse ishte i zënë. Portieri foli e foli pa pushim, më pas takova drejtorin: më priti në zyrën e vet. Ishte një burrë i vjetër, trupshkurtër, mbante varur dekoratën e "Legion d'honneur". Më vështroi me sytë e tij të çelët. Pastaj më shtrëngoi dorën e ma mbajti kaq gjatë sa nuk dija si ta tërhiqja. Shfletoi një dosje e më tha: "Zonja Merso ka ardhur këtu para tre vjetësh. Ju ishit mbështetja e saj e vetme. M'u duk sikur po më qortonte për diçka dhe fillova t'i shpjegoj. Por ai më ndërpreu: "S'keni pse të shfajësoheni, biri im. Lexova dosjen e nënës suaj. Ju nuk kishit mundësi ta mbanit. Kishte nevojë për njeri. Të ardhurat tuaja janë të pakta. E në fund të fundit ajo ishte më e lumtur këtu". Unë i thashë: "Po, zoti drejtor". Ai shtoi: "Ju e dini, ajo kishte miq të moshës së saj. E lidhnin me ta interesa që i përkasin një kohe tjetër. Ju jeni i ri dhe ajo duhet të mërzhitej me ju."

46. Si reagon Merso ndaj vdekjes së nënës?

1 pikë

- A) Shfaq një hutim të vazhdueshëm.
- B) Përjeton një tronditje të thellë shpirtërore.
- C) Paraqitet i ftohtë në atë situatë.
- D) E mbyl mërzhia dhe trishtimi.

47. Shqetësimi kryesor i Mersoit lidhet me:

1 pikë

- A) humbjen e papritur të nënës.
- B) rrugën e gjatë për të shkuar deri në azil.
- C) informacionin e paplotë të telegramit.
- D) mënyrën sesi duhet t'ua shpjegojë eprorëve situatën.

- 48.** Si ndihet Mersoi kur i kërkon leje pronarit? **1 pikë**
- A) I tensionuar që po kërkon leje për diçka personale.  
B) I ftohtë, pasi kërkesa për leje është formale.  
C) I përfshirë në një gjendje faji të pakuptimtë.  
D) I zemëruar, për shkak të reagimit të pronarit.
- 49.** Pse Mersoi e vizitonte rrallë nënën në azil? **1 pikë**
- A) Azili ishte larg, i kushtonte shumë dhe duket se pak i interesonte nëna.  
B) Ai respektoi dëshirën e nënës për të ndenjur në vetmi të plotë.  
C) Ai e urrente stilin e jetesës së nënës së tij.  
D) Ai nuk ishte dakord me mënyrën sesi nëna i zgjidhte miqtë e saj.
- 50.** Cili nga personazhet nuk shfaq keqardhje për vdekjen e nënës së Mersoit? **1 pikë**
- A) Drejtori i azilit.  
B) Emanueli.  
C) Mikesha e tij, Çeleste.  
D) Pronari i tij.
- 51.** Sjellja e pronarit me Mersoin, nisur nga këndvështrimi i këtij të fundit, është: **1 pikë**
- A) e pakuptimtë dhe e çuditshme.  
B) e ftohtë dhe përçmuese.  
C) e ngrohtë dhe dashamire.  
D) e natyrshme dhe mirëkuptuese.
- 52.** Një nga reagimet e çuditshme të Mersoit, në sytë e lexuesit, është: **1 pikë**
- A) fakti që përlogarit orët për të arritur te nëna.  
B) nxitimi për të kapur autobusin.  
C) reagimi pasi merr telegramin.  
D) shmangia nga bisedat me të tjerët gjatë udhëtimit.
- 53.** Nisur nga fragmenti, ajo që e shtyn Mersoin në grackën e absurdit, është: **1 pikë**
- A) fakti që Mersoi është i pandjeshëm ndaj një dhimbjeje të tillë familjare, ndërkohë që të tjerët shqetësohen për të.  
B) mënyra sesi ai përballet me vdekjen e nënës, kundrejt mënyrës sesi i shohin të tjerët veprimet e tij.  
C) qëndrimi shpërfillës i të tjerëve kundrejt situatës së Mersoit, sado që ajo është e dhimbshme.  
D) rënia fizike, shpirtërore e mendore e Mersoit pasi humbet nënën.
- 54.** Cila është e dhëna që gjejmë në këtë fragment, e cila do ta rëndojë Mersoin në rrjedhën e mëpastajme të jetës së tij? **1 pikë**
- A) Mersoi shkon në azil me autobus.  
B) Mersoi nuk komunikon me pasagjerin në autobus.  
C) Mersoi merr hua kravatën dhe shiritin e zi për varrimin e nënës.  
D) Mersoi nuk reagon ndaj gjyqimit të Çelestes se *të gjithë një nënë kemi*.

- 55.** Pika e dobët e Mersoit është: **1 pikë**
- A) kujtimi i nënës që s'është më.
  - B) kujdesi për veshjen ceremoniale.
  - C) marrëdhënia me pronarin.
  - D) ndjeshmëria ndaj të nxehtit.
- 56.** Cila nga fjalitë e mëposhtme mbart dy kuptime? **1 pikë**
- A) S'është për fajin tim.
  - B) S'keni pse të shfajësoheni, biri im.
  - C) Ju jeni i ri dhe ajo duhet të mërzitej me ju.
  - D) Zonja Merso ka ardhur këtu para tre vjetësh.
- 57.** Cila është arsyeja që autori e sjell rrëfimin në vetën e parë? **1 pikë**
- A) Për të evituar stilin e zhveshur dhe telegrafik të fragmentit.
  - B) Për të dhënë në mënyrë të drejtpërdrejtë perceptimin e Mersoit për botën.
  - C) Për të mundësuar përjetimin nga afër të emocioneve dhe ndjenjave të Mersoit.
  - D) Për të siguruar distancën e komunikimit mes lexuesit dhe personazhit kryesor.
- 58.** Cila nga alternativat e mëposhtme konsiderohet si një nga frazat më interesante në mbarë letërsinë ekzistencialiste? **1 pikë**
- A) Në orën dy mora autobusin. Bënte shumë nxehtë.
  - B) Madje dhe i thashë: "S'është për fajin tim." Nuk u përgjigj.
  - C) Sot më vdiq mamaja. Apo ndoshta dje, nuk e di.
  - D) Tani për tani duket sikur mamaja nuk ka vdekur.
- 59.** Shprehja e Mersoit: *Portieri foli e foli pa pushim,...* është teknikë që shërben: **1 pikë**
- A) për të krijuar një kontrast mes Mersoit dhe të tjerëve.
  - B) për të karakterizuar personazhin e portierit si fjalëshumë.
  - C) për të dhënë përçmimin e Mersoit për portierin.
  - D) për të shprehur karakterin vëzhgues të Mersoit.
- 60.** Telegrami është në vetvete absurd, pasi: **1 pikë**
- A) nuk e bën të qartë shkakun e vdekjes së nënës.
  - B) nuk jep të dhëna të sakta kohore dhe vendore.
  - C) ngushëllimet e sjella në të janë të pasinqerta.
  - D) i mungon vërtetësia dhe ndjeshmëria.